



# **STARTAPET: PËR NOVATORËT APO TË PËRZGJEDHURIT?**

**RAPORT MONITORIMI**

**Tetor-Dhjetor 2022**



**AUTOR  
RENIS META**

**QENDRESA  
QYTETARE**



**NED**

**NATIONAL  
ENGAGEMENT  
FOR  
DEMOCRACY**

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Tabela e Përmbajtjes

- Hyrje
- Ligji Nr. 25/2022, “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”
- Thirrja për aplikim për grante për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve
- Problematikat e shfaqura gjatë të procesit të dhënies së për granteve për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve
- Konkluzione & Rekomandime
- Bibliografia

## Hyrje

Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri ka njohur zhvillim vitet e fundit dhe vëmendja po zhvendoset drejt inovacionit, sipërmarrjes dhe krijimit të ekosistemeve që promovojnë startup-et dhe inovacionin. Ekosistemi i startupeve në Shqipëri është ende në fazat e para të zhvillimit, ku shumica e iniciativave janë ende në fazën e "vetëdijes dhe frymëzimit". Veçanërisht jashtë kryeqendrës së vendit, Tiranës, ekosistemi mbetet i pazhvilluar (Hach.K & Trenkmann.E., 2019, fq.4).<sup>1</sup> Sektori publik dhe kryesisht ai privat kanë bërë përpjekje për të nxitur zhvillimin e startup-eve dhe sipërmarrjes inovatore, por infrastruktura e përgjithshme e mbështetjes së inovacionit mbetet ende e fragmentuar, ku bashkëpunimi midis institucioneve, universitetit dhe sektorit privat është aktualisht shumë i ulët me palët që nuk e shfrytëzojnë potencialin për të bashkëpunuar.

Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri është i përqëndruar në Tiranë dhe mbetet e vështirë nxitja e sipërmarrjeve inovatore dhe ekosistemit të startup-eve jashtë kryeqytetit, pasi pjesa më e madhe e qyteteve të tjera përballen me një ikje të lartë të trurit drejt Tiranës apo zgjedhin të lenë vendin. Po ashtu, jashtë kryeqendrës së vendit, shumica e iniciativave fokusohen në krijimin e mjeteve të jetesës dhe sipërmarrjen tradicionale në shkallë të vogël në sektorë të fillë si turizmi, bujqësia, zeytaria, etj. Për më tepër, shumica e iniciativave në qytete të tjera të vogla, që operojnë nën labelin e startup-it nuk mund të klasifikohen si të tilla, duke pasur parasysh mundësitë e tyre të kufizuara të rritjes (Hach.K & Trenkmann.E., 2019, fq.4-5).

Shqipëria është rënditur në vend të 75-të në Indeksin Global të Ekosistemit të Startup-eve për vitin 2022, të publikuar nga "Startup Blink". Nëse krahasojmë Shqipërinë me rajonin shohim se Serbia dhe Maqedonia e Veriut qëndrojnë para nesh në renditje, ndërkohë kemi lënë pas Bosnje Hercegovinën dhe Kosovën e cila është bërë për herë

---

<sup>1</sup> Hach.K & Trenkmann.E. (2019). Entrepreneurial & Innovation Ecosystem in Albania.

të parë pjesë e Indeksit për vitin 2022 (StartUp Blink, 2022).<sup>2</sup> Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri duke qenë ende në fillimet e tij, mbetet jo konkurues në rajon dhe në tregun europian. Për të konkurruar me partnerët rajonal dhe më gjerë, është thelbësore që ekosistemi shqiptar i startup-eve të bëjë hapa cilësorë dhe të kalojë në fazën e "Zgjimit dhe Manifestit", ku sigurisht një rol të rëndësishëm ka qeveria që duhet të jetë në linjën e parë të mbështetjes financiare dhe krijimit të lehtësirave për startup-et (Hach.K & Trenkmann.E., 2019, fq.5).

### **Ligji Nr. 25/2022, "Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve"**

Në vend ka munguar një kuadër ligjor i plotë që rregullonte ekosistemin e startup-eve dhe aktivitetin e këtyre sipërmarrjeve, për pasojë lindi nevoja e një ligji të ri që adresonte të gjitha nevojat e sektorit. Në dhjetor të vitit 2021, Këshilli i Ministrave propozoi projektligjin "Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve inovative", duke u fokusuar në krijimin e një kuadri normativ e institucional të favorshëm për këto sipërmarrje.

Në mars 2022, Parlamenti miratoi ligjin Nr. 25/2022, 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve', ligj i cili përcakton rregullat bazë, procedurat, si dhe organet shtetërore kompetente për vetëdeklarimin, mbështetjen, zhvillimin dhe monitorimin e startup-eve dhe të ekosistemit mbështetës të tyre në Republikën e Shqipërisë.<sup>3</sup>

Ligji synon krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e startup-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të tyre, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve inovative, si dhe modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë për zhvillimin ekonomik.<sup>4</sup>

Gjatë kësaj periudhe u kaluan aktet nënligjore ku janë përcaktuar kriteret, fashat e përcaktimit të startupeve, si dhe lehtësirat në mbështetjeve të startup-eve.

<sup>2</sup> StartupBlink. (2022). Global Startup Ecosystem Index 2022.

<sup>3</sup> Ligj Nr. 25/2022, 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve'

<sup>4</sup> Ligj Nr. 25/2022, 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve'



- Vendim Nr.314, datë 11.5.2022, Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Organizimin, Funkcionimin, Përbërjen, Kriteret dhe Procedurën e Përzgjedhjes, si dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit të Start Up-eve.
- Vendim Nr.313, datë 11.5.2022, Për Miratimin e Rregullave të Hollësishme për Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Krieteve, Procedurës së Përzgjedhjes dhe Shpërblimit të Anëtarëve të tij.
- Vendim Nr.312, datë 11.5.2022, Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Përbajtjen e Regjistrimit të Start Up-eve dhe Lehtësuesve, Mënyrën e Funkcionimit dhe Ndërlidhjen e tij me Portalin Qeveritar “E- Albania”, si dhe për Dokumentet Elektronike – Pasaporta e Start Up-eve dhe Pasaporta e Lehtësuesve.
- Vendim Nr.311, datë 11.5.2022, Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Veprimtarinë dhe Mënyrën e Ofritit të Shërbimit Start Up One-Stop-Shop, si dhe Shërbimeve për të Cilat Aplikohet Tarifa Zero për Mbështetjen e Start Up-eve.
- Vendim Nr.315, datë 11.5.2022, Për Përcaktimin e Kërkesave dhe Krieteve që Duhet të Plotësojnë Start Up-et dhe Lehtësuesit e Startup-eve, si dhe Miratimin e Procedurave dhe Afatave të Thirrjes për Përfitim të Granteve dhe Masave Mbështetëse.

### **Thirrja për aplikim për grante për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve**

Më 16 maj 2022, u hap Thirrja e Parë e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për Startup-et dhe Lehtësuesit, thirrje që qëndroi e hapur deri në datë 10 qershor 2022. Ky proces nisi me deklarin online në E-Albania dhe gjenerimin e pasaportës së startupit dhe nga ky moment niste pjesa 24 mujore e shërbimit “One Stop Shop”. Ky shërbim do të ofrohej nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, ku përveç mbështetjes financiare, startup-et do të marrin edhe këshillim pranë këtij ‘One Stop Shop-i’.

Synimi i thirrjes ishte të ndihmonte në krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen, përfshirjen dhe mbajtjen e talentit dhe burimeve njerëzore, lehtësimin dhe mbështetjen në aksesimin e burimeve financiare dhe përfshirjen sociale dhe diversitetin në mbrojtje të vlerave demokratike, nxitjen dhe futjen e inovacionit në sektorët ekonomikë.<sup>5</sup>

### **Kategoritë Përfutuese të Grantit**

Ky grant parashikonte mbështetjen e dy kategorive aplikuesish siç janë startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve. Secila kategori klasifikohet në nën-kategori aplikuesish si më poshtë:

#### **Për startup-et:**

- Startup-et në fazën fillestare;
- Startup-et në fazën e rritjes;
- Startup-et në fazën e zgjerimit.

#### **Për lehtësuesit e startup-eve:**

- Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private;
- Lehtësuesit, si inkubatorët dhe përsheptuesit;
- Hapësirat e përbashkëta të punës, të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës; Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës;
- Organizuesit e eventeve;
- Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private.<sup>6</sup>

Ndërkohë, pas përmbylljes së fazës së parë të aplikimeve, 52 aplikantët fitues kanë arritur të vlerësohen me mbi 80 pikë. U shpallën 23 fituesit që do të përfitojnë nga fondi dedikuar për "startup-et" dhe 29 lehtësues startup-esh. Startup-et dhe lehtësuesit, të cilët plotësonin

<sup>5</sup> Faqja zyrtare e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

<sup>6</sup> Ligj Nr. 25/2022, 'Për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve'

kriteret, do të financoheshin me grante nga buxheti i shtetit për të mbështetur projektet e tyre.

Qeveria ka vendosur një fond prej 2 milionë euro në dispozicion të fituesve dhe referuar programit qeverisës për 4 vitet e ardhshme, buxheti në mbështetje të Startup-eve do të 5-fishohet duke arritur deri në 10 milionë euro.<sup>7</sup>

### **Problematikat e shfaqura gjatë të procesit të dhënies së për granteve për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve të startup-eve**

Referuar Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, rreth 400 biznese, individë, organizata jofitimprurëse, bashki, universitete dhe entitete të ndryshme paraqitën projektet e tyre për përfitimin e granteve për startup-et.

Të gjitha aplikimet u morën në shqyrtim nga Komisioni i Vlerësimit, i cili do përbehej nga vetë Ministri i Sipërmarrjes, dhe katër anëtarë (një anëtar që do të caktohej nga vetë Ministri i Sipërmarrjes, një anëtar do të përcaktohej nga Ministri për Rininë dhe Fëmijët, një ekspert nga sistemi i ekosistemeve dhe startup-eve, për të cilin më pas do të hapej dhe një konkurs, si dhe një anëtar nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim).

Gjatë procesit, nuk u bë publike se cilët do të ishin përfaqësuesit e institucioneve në bordin e vendimmarrjes, duke ngritur pikëpytjet nëse anëtarët e përzgjedhur do të kishin përvojën dhe ekspertizën e duhur në fushën e inovacionit. *Për më tepër, çdo funksionar publik që përfshihet në rregullimin e skemave të tilla do duhej domosdoshmërisht të kishte një lidhje të fortë me inovacionin dhe startup-et.*

Lista e përfaqësuesve që do të ishin pjesë e bordit vendimmarrës do të bëhej publike vetëm pas polemikës mediatike të nxitur nga emisioni investigativ "Piranja", ku nëpërmjet ankimit tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit, si dhe pas seancës dëgjimore mes palës që kishte ngritur ankesën dhe autoritetit publik, konkretisht Ministrisë së Shtetit për

---

<sup>7</sup> Faqja zyrtare e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Mbrojtjen e Sipërmarrjes, komisioneri do të vendoste pranimin e ankesës dhe urdhërimin e ministrisë për dhënien e informacionit të kërkuar, duke bërë publike emrat e anëtarëve të komisionit.

Duke përshkruar dhe analizuar listën e 23 kompanive të startup-it, fituese të granteve, ngremë pikëpyetjet nëse këto iniciativa mund të cilësohen si inovatore? Për më tepër, a është i lidhur qëllimi dhe objekti i aktivitetit të këtyre subjekteve me inovacionin dhe teknologjinë dhe a janë një risi në ekosistemin e startup-it në vend projektet fituese?

Nga një shqyrtim i aktiviteteve të subjekteve në fjalë vihet re qartësisht që një pjesë e tyre nuk kanë si objekt të aktivitetit të tyre zhvillimin e teknologjisë apo inovacionin. Nëse i referohemi Ligjit Nr. 25/2022 “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”, për një kompani që të jetë e regjistruar si e tillë, duhet të konceptohet dhe të veprojë me qëllimin e caktuar për të realizuar apo zhvilluar një produkt apo shërbim i cili duhet të konsiderohet inovativ ose teknologjik i veçantë me potencial rritjeje të shpejtë, për përmirësimin e modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese. Ku qëndron inovacioni dhe teknologjia në kompani apo entitete të cilat në përshkrimin e objektit dhe veprimtarisë së tyre cilësohen si konsulence financiare, promovim përmes videove, shërbime/kurse kontabiliteti, apo aktivitete artizanale, etj?

***Bazuar në Nenin 3, pika d) të Ligjit Nr. 25/2022 “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve”: “Startup” konsiderohen individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese.***



Një pjesë e përfituesve të granteve nuk kanë një lidhje të qartë me inovacionin dhe nuk mund të kategorizohen nën label-in e startup-it, një kusht bazë për dhënien e grantit.

Disa prej rasteve të bëra publike kanë evidentuar cënimin e qartë të procesit përmes ndërhyrjeve dhe lidhjeve në procesin e dhënies së granteve duke ngritur pikëpyetje mbi transparencën dhe ligjshmërinë e këtij procesi.

Një prej përfituesve të grantit nën label-in e startup-it është një subjekt i cili do të bëjë promovimin e atraksioneve turistike të vendit nëpërmjet publikimit të videove përmes krijimit të një faqeje ëeb. Po ashtu, një prej përfituesve të grantit i konsideruar si aktivitet artizanal, që merret me përpunimin e mëndafshit, ka përfituar grantin për blerjen e makinerive për përpunimin e mendafshit. duke ju referuar vetëm dy prej rasteve evidentojmë qartësisht se asnjë prej subjekteve nuk ka elementet bazë të përcaktuara për tu konsideruar një sipërmarrje inovatore me qëllim zhvillimin ekonomik, siç përcaktohet në ligjin për startup-et.

Po ashtu, një tjetër problematikë me procesin e dhënies së granteve ishte përfitimi i granteve nga dy entitete më të njëjtën adresë vendodhje dhe ku personi fizik figuron ortak në të dyja subjektet. Sipas, VKM. Nr.312, datë 11.5.2022, *“Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Përmbajtjen e Regjistrimit të Start Up-eve dhe Lehtësuesve, Mënyrën e Funkcionimit dhe Ndërlidhjen e tij me Portalin Qeveritar ‘E- Albania’, si dhe për Dokumentet Elektronike – Pasaporta e Start Up-eve dhe Pasaporta e Lehtësuesve”* në të dhënat parësore dhe dytësore në regjistrin e Startup-eve përfshihen edhe të dhënat e regjistrimit tregtar dhe numri i identifikimit të subjektit. Pra, komisioni i vlerësimit nuk ka arritur të identifikojë subjektet që kanë adresë të njëjtë, dhe se në të dyja projektet përfitues është i njëjti person.

Një tjetër çështje që nxit diskutime lidhet me rolin e subjekteve që operojnë si lehtësues dhe rolin e tyre në nxitjen e inovacionit. Lehtësuesit janë entitete që ofrojnë shërbime për Startup-et, si

inkubatorët, akseleratorët, universitetet, etj. Profili i një lehtësuesi mund të jetë divers duke nisur nga një shkollë profesionale, e duke vazhduar me universitete e organizata, etj. Sipas listës së fituesve, janë rreth 29 lehtësues të cilët kanë përfituar nga 1.000.000 lekë deri në 20.000.000 në formën e granteve për tu përdorur në lehtësimin e kompanive startup.

Vlerat e granteve të dhëna për lehtësuesit janë të konsiderueshme dhe profilet e disa prej lehtësuesve të përzgjedhur nuk përkojnë me qëllimet dhe fokusin që duhet të ketë një lehtësues startup-i. Natyrshëm lind pyetja si do të përdoren këto fonde nga lehtësuesit dhe në çfarë forme do u ofrojnë lehtësim startup-eve. Theksojmë këtu se një vlerë e konsiderueshme financimi është përfituar nga entitete të cilat kanë si subjekt organizimin dhe menaxhimin e eventeve, pa pasur një lidhje të drejtpërdrejtë me ekosistemin e startup-eve dhe inovacionin. Komisioni ka vendosur se këto entitete përfituese të grantit si lehtësues kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e një kompanie startup dhe sidomos të teknologjisë.

Po ashtu, nga lista e publikuar gjenden 7 bashki të cilat do të përfitojnë grante deri në 20 milionë. Duke njohur kapacitetet dhe performancën e bashkive në vendin tonë, mbetet ende në pikëpyetje se si këto institucione do të mund të ofrojnë shërbime lehtësuese për startupet. Çfarë procesi lehtësimi do tu ofrojnë këto bashki startupeve? A janë vlerësuar kapacitetet institucionale dhe mundësitë reale që këto institucione kanë për të nxitur ekosistemin e startup-eve nga Komisioni?

## Përfundime & Rekomandime

- Grantet e Startup-eve kanë qenë në fokus të vëmendjes publike ku u evidentuan për publikun e gjerë raste të dhënies së granteve në bazë preferencash duke sjellë favorizimin e disa prej entiteteve të cilat ishin pjesë e listës fituese.

Nga monitorimi i procesit të dhënies së granteve nga QQ u evidentua se procesi është minuar në transparencën dhe kredibilitetin e tij nëpërmjet dhënies së granteve në bazë preferencash dhe në konflikt interesi. Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes duhet të garantojë transparencën e procesit të implementimit të projekteve fituese dhe se si këto projekte do të përkthehen në kontribut për ekonominë e vendit dhe ekosistemin e startup-eve.

- Pjesa më e madhe e fondeve për zhvillimin dhe financimin e startup-eve janë të kanalizuar kryesisht në Tiranë dhe kryeqyteti mbetet qendra e vetme e inovacionit në vend. Për të nxitur trajektoren e rritjes së inovacionit në vend, qeveria duhet të mbështesë zhvillimin e iniciativave jashtë Tiranës të cilat janë realisht inovatore dhe kanë elementët e një startup-i dhe jo entiteteve të cilat nuk kanë lidhje me industrinë apo inovacionin, dhe të përpiqet nxisë ekosistemin e startup-eve jashtë kryeqendrës së vendit.
- Startup-et janë një mënyrë për të frenuar emigracionin e të rinjve dhe inkurajimi dhe mbështetja e financiare është e rëndësishme për të vlerësuar të rinjtë dhe individët që duan të zhvillojnë idetë e projektet e tyre dhe aspirojnë të kontribuojnë në vendin e tyre. Nëse kërkojmë arsyet pse të rinjtë apo profesionistët lënë Shqipërinë atëherë na mjafton evidentimi i mënyrës se si mundësitë që duhet t'ju ofrohen të rinjve dergjen tjetërkund dhe i jepen gjithkujt pos atyre.

## Bibliografia

StartupBlink. (2022). Global Startup Ecosystem Index 2022. *Aksesuar në:*  
<https://www.startupblink.com/startupecosystemreport>

Hach.K & Trenkmann.E. (2019). Entrepreneurial & Innovation Ecosystem in Albania.  
*Aksesuar në:* <https://euforinnovation.al/wp-content/uploads/2020/03/e-publication-of-the-regional-gap-analysis.pdf>

Ligj Nr. 25/2022, "Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve".

Vendim Nr.314, datë 11.5.2022, Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Organizimin, Funkionimin, Përbërjen, Kriteret dhe Procedurën e Përzgjedhjes, si dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit të Start Up-eve  
*Aksesuar në:* <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-314-Dt.11.05.2022.pdf>

Vendim Nr.313, datë 11.5.2022 Për Miratimin e Rregullave të Hollësishme për Përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të Kriterëve, Procedurës së Përzgjedhjes dhe Shpërblimit të Anëtarëve të tij.  
*Aksesuar në:* <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-313-Dt.11.05.2022.pdf>

Vendim Nr.312, datë 11.5.2022 Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Përmbytjen e Regjistrimit të Start Up-eve dhe Lehtësuesve, Mënyrën e Funkionimit dhe Ndërlidhjen e tij me Portalin Qeveritar "E- Albania", si dhe për Dokumentet Elektronike – Pasaporta e Start Up-eve dhe Pasaporta e Lehtësuesve.  
*Aksesuar në:* <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-312-Dt.-11.05.2022.pdf>

Vendim Nr.311, datë 11.5.2022 Për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Veprimtarinë dhe Mënyrën e Ofrimit të Shërbimit Start Up One-Stop-Shop, si dhe Shërbimeve për të Cilat Aplikohet Tarifa Zero për Mbështetjen e Start Up-eve.  
*Aksesuar në:* <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-311-Dt.11.05.2022.pdf>

Vendim Nr.315, datë 11.5.2022 Për Përcaktimin e Kërkesave dhe Kriterëve që Duhet të Plotësojnë Start Up-et dhe Lehtësuesit e Startup-eve, si dhe Miratimin e Procedurave dhe Afatave të Thirrjes për Përfitim e Granteve dhe Masave Mbështetëse.  
*Aksesuar në:* <https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/VKM-315-Dt.11.05.2022.pdf>

Rregullore për Përcaktimin e Rregullave të Hollësishme për Kryerjen e Monitorimit, Raportimit dhe Dokumentacionin e Nevojshëm për t'u Paraqitur nga Startup-et dhe Lehtësuesit e Startup-eve që Aplikojnë për Masa Mbështetëse. *Aksesuar në:*



<https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/RREGULLORE-E-FUNKSIONIMIT-TE%CC%88-GRANTIT.pdf>

Faqja zyrtare e Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

<https://sipermarrja.gov.al/vkm-2/>

<https://sipermarrja.gov.al/bilali-kane-aplikuar-400-startup-e-per-pasaporten-e-startup-it-aplikimi-per-pasaporte-deri-me-3-qershor/>

<https://sipermarrja.gov.al/keshilli-i-ministrave-kalon-projektligjin-per-startup-et-ministrja-bilali-shpjegon-proceduren-qe-duhet-te-ndiqet-per-regjistrimin-e-startup-eve/>

<https://sipermarrja.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Ligji-p%C3%ABr-mb%C3%ABshtetjen-dhe-zhvillimin-e-startup-eve.pdf>

Emissioni Investigativ "Piranja"

<https://piranjat.al/2022/12/18/start-up-et-dhe-konflikti-i-interesit-a-genjen-ministrja/>

Boldnews.al

<https://boldnews.al/2022/12/26/skandali-i-start-up-eve-grantet-i-marrin-njerezit-me-lidhje-politike/>

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)